

H. 27. 06. 2018

**STATUT
I
SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "KF ALBANIA LIGHTING SOLUTIONS" sh.p.k.**

KREU I

EMERTIMI, OBJEKTI I VEPRIMTARISE, SELIA, KOHEZGJATJA

EMERTIMI

Neni 1

Duke u bazuar ne: Kushtetuten dhe Kodin Civil ne Fuqi te Republikes se Shqiperise, ne ligjin Nr. 7512 Dt.10.08.1991 "Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private, te nismes se lire dhe privatizimit" ne nenin 11 te ligjit Nr.9901 Date 14.04.2008" Per shoqerite tregtare dhe ne ligjin Nr. 9723 Date 3.5.2007 per Q.K.R me vullnetin e tije te lire per te shprehur dhe ne nenshkrimin e akt themelimit (qe I bashkengjitet ketij statuti), sot me Date. 27.06.2018, ortaku i vetem Z. **PAULIN FERKO** i datelindjes 27.10.1990, lindur ne Fier dhe Banues ne Rrugen "Nestor Pogace", Mbrostar Ferko, Rrethi Fier, krijon shoqerine me pergjegjesi te kufizuar "KF ALBANIA LIGHTING SOLUTIONS"sh.p.k

Neni 2

Shoqeria "KF ALBANIA LIGHTING SOLUTIONS" sh.p.k gjendet ne Rrugen "Nestor Pogace", Mbrostar Ferko, Rrethi Fier mund te ndryshoje seline e saj me vendim te Asamblese se Ortakeve(ortakut te vetem).

SELIA E SHOQERIS

Neni 3

Selia e shoqerise gjendet ne Rrugen "Nestor Pogace", Mbrostar Ferko, Rrethi Fier. Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj me vendim te Asamblese se Ortakeve(ortakut te vetem).

Neni 4

Shoqeria e zhvillon aktivitetin ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe me statutin e saj, ne territorin e Republikes se Shqiperise dhe jashte saj. Shoqeria mund te krijojte filial ne vende ne perputhje me legjislacionin e vendit perkates.

FUSHA E AUTORITETIT TE ORTAKEVE(Ortakut te Vetem)

Neni 5

Fusha e autortitetit te ortakeve(ortakut te vetem) dhe perqindja e fitimeve dhe humbjeve do te kene si kriter baze kapitalin e shoqerise si dhe kompetencat qe gezon ne marjen e vendimeve te cdo karakteri, te percaktuara ne kete statut.

LIBRI I SHOQERISE

Neni 6

Per te precizuar e per te saktësuar veprimtarine e vete ekonomike si dhe marredheniet e punes, shoqeria do te cele librin e vet, i cili do te quhet libri i shoqerise.

KONFIDENCIALITETI

Neni 7

Ortakut(ortaku i vetem), si dhe personat e tjere te pranuar ne shoqeri, bien dakord qe te mos i ekspozojne asnje personi te jashtem informacionet qe do te disponoje shoqeria, kontratat qe ajo do te lidh, si dhe planet ose qellimet qe ajo ka per te ardhme e saj.

Neni 8

Te gjithë aktet dhe dokumentet qe nxirren nga shoqeria dhe te destinuara per te tretet, si: letrat, faturat, lajmerimet dhe publikimet e ndryshme etj, duhet te tregojne lexueshem: emrin e shoqerise dhe pas tij fjalet- shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, ose iniciais-sh.p.k dhe emrin e administratorit.

Neni 9

Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj në fushën e:

Import – Export të pajisjeve dhe pjesëve ndërcuse për Apartamente, Bure, Lokale, Zyra
Pajisjet ndërcuse do të jenë Abazhur, Llamba, Spote dhe të gjitha nënprodhimet e tyre

KOHEZGJATJA

Neni 10

Jetëgjatësia e shoqërisë do të jetë pa afat, por ajo mund të shpërndahet edhe para këtij afati të përcaktuar me sipër me vendim të Asamblesë së Ortakëve (Ortaku i vetëm) të shoqërisë, si dhe kur merr fund aktiviteti i saj apo kur shpërndarjen e saj e përcakton ligji.

KREU II

KAPITALI THEMELTAR, KUOTAT

Neni 11

Kapitali themeltar i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “**KF ALBANIA LIGHTING SOLUTIONS**” sh.p.k është 100.000 (njëqind mijë) leke. Ky Kapital është teresisht i nënshkruar dhe i shlyer nga ortakët i vetëm të shoqërisë. Shoqëria mund të shtojë ose pakësojë kapitalin e saj deri në limitin e përcaktuar me ligj, me vendim të Asamblesë së Ortakëve (ortakut të vetëm).

Kapitali themeltar përbehet nga kontributi i mëposhtëm: 100.000 (njëqind mijë) lek ose 100% të kapitalit themeltar.

Neni 13

Lenia dhe transferimi i pjesëve të kapitalit:

Kapitali themeltar është lirisht i transferueshem tek personat e tretë, n.q.s Asambleja e miraton.

Neni 14

Asambleja e Ortakëve (Ortaku i vetëm), miraton llogaritë, nëse është e nevojshme pas raportit të ekspertëve kontabel të autorizuar brenda 6 muajve nga mbyllja e vitit financiar, merr vendim për ndryshimet që mund të pesojë statuti, për ndryshimin e masës së kapitalit themeltar dhe shdërrimin e shoqërisë në një formë tjetër, për punësimin e punonjësve dhe pagat, si dhe problemet e tjera të lidhura me punësimin në zbatim të legjislacionit shqiptar etj. Vendimet e Asamblesë së ortakëve (Ortaku i vetëm) evidentohen në një regjister.

ORGANET DREJTUESE

Neni 15

Organi vendimor i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “**KF ALBANIA LIGHTING SOLUTIONS**” sh.p.k është Asambleja e Ortakëve (Ortaku i vetëm) të shoqërisë, e cila zgjedh administratorët që do të hyjnë në marrëdhënie me të tretët.

Neni 16

Shoqëria, drejtohet nga administrator në funksion që kryhet nga Z. **PAULIN FERKO** të cilit i atribuohen të gjithë kompetencat, përveç atyre të cilat ligji ia nënshprehimisht Asamblesë së Ortakëve (Ortaku i vetëm).

Administratori qëndron në detyrë nga data 27.06.2018 deri me datë 26.06.2023, për një periudhë 5-vjeçare me të drejtë rizgjedhje.

LIBRAT E SHOQËRISË, BILANCI, SHPËRNDARJA DHE LIKUJDIMI

Neni 17

Shoqëria është e detyruar të mbajë përveç dokumentacionit kontabel ose librave të tjera edhe: Librin e shoqërisë në të cilin shënohet: Emrat e Ortakëve, kapitali themeltar si dhe vendimet e Asamblesë (Ortakut të vetëm).

PUNESIMET NE SHOQERI

Neni 18

Per punonjesit qe do te punesohen, marredheniet juridike midis shoqerise dhe te punesuarve do te rregullohen me kontraten e punes ne perputhje me dispozitat ligjore dhe Kodin e Punes.

Neni 19

Shoqeria merr persiper te derdh rregullisht te gjitha detyrimet, gjithashtu dhe kontributet per sigurimin e te punesuarve te saj ne organet kompetente perkatese sipas ligjit.

BILANCI

Neni 20

Shoqeria eshte e detyruar te dorezoje bilancin brenda afateve te caktuara ne ligjin mbi kontabilitetin.

SHPERNDARJA DHE LIKUJDIMI

Neni 21

Shoqeria mbaron me vendim te Asamblese se Ortakeve(Ortakut te vetem) ose kur ka nje prishje te parakoheshme per arsyet e parashikuara ne ligj.

Neni 22

Shoqeria hyn ne procesin e likujdimit qe ne momentin e prishjesh se saj. Per kryerjen e ketij procesi, Asamblea e Ortakeve (Ortaku i vetem) cakton nje ose disa likujdator, te cilet i paraqesin asaj raportin mbi gjendjen e aktivitetit dhe te pasivit te shoqerise, mbi ndjekjen e operacioneve te likujdimit dhe mbi afatin e nevojshem te perfundimit te tyre. Ne fund te procesit te likujdimit, Asamblea e Ortakeve(Ortaku i vetem) vendos mbi bilancin perfundimtar financiar dhe mbi mbylljen e procesit te likujdimit. Pas pagimit te likujdatoreve, Asamblea e Ortakeve(Ortaku i vetem) mban pjesen e mbetur te kapitalit.

ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE

Neni 23

Te gjitha mosmarreveshjet qe mund te lindin gjate ekzistences se shoqerise ose gjate periudhes se likujdimit, do ti paraqiten per zgjidhje gjykates kompetente.

DISPOZITAT E FUNDIT

Neni 24

Ky statut u hartua ne 4 (kater) kopje ne gjuhen Shqipe, duke patur secila kopje fuqi te njejte ligjore. Persa nuk eshte shprehur ne kete statut, do te bazohet ligji "Per Shoqerite Tregtare" dhe Kodi Civil i Republikes se Shqiperise qe eshte ne fuqi.

Ortaku I Vetem

PAULIN FERKO

